



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 803/1 /prot.

Tiranë, më 24.05.2024

VENDIM
Nr. 51 datë 24.05.2024

“Për krijimin e Muzeut Arkeologjik Autonom pranë Akademisë së Shkencave”

Në zbatim të nenit 4, pika 12 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 59 të Statutit të ASH-së, nenit 214, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 28.12.2023 “Për ngritjen dhe organizimin e njësisë të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 24.05.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin e krijimit të Muzeut Arkeologjik Autonom pranë Akademisë së Shkencave (me vendndodhje në Tiranë, me adresë sheshi “Nënë Tereza”, nr. 3), që ka për mision promovimin e trashëgimisë arkeologjike, historike dhe kulturore të lidhura me historinë e kombit shqiptar, përmes ekspozimit të gjetjeve arkeologjike të Institutit të Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave.
2. Miratimin e Statutit të funksionimit të këtij muzeu dhe të stemës së tij sipas lidhjes nr.1, bashkëngjitur.
3. Miratimin e listës dhe koleksionit muzeor të objekteve muzeore që do të ekspozohen në muze, të kataloguara pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, lidhjes nr. 2, bashkëngjitur.
4. Muzeu funksionon në bazë të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave”, i ndryshuar, ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të këtij vendimi dhe të Statutit të tij.
5. Muzeu realizon veprimtarinë e tij në bashkëpunim me:
 - organet e administratës shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore;
 - rrjetin muzeor shqiptar;

- muzetë kombëtarë, muzetë tipologjikë, muzetë vendorë, muzetë privatë, për të lërhequr në fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si dhe për ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta;
- institucione shkencore, kulturore, artistike dhe fetare, individë, persona fizikë e juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin e restaurimin e objekteve, pjesë e fondit të tij, që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore;
- institucione të huaja simotra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë në çdo rast miratimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

6. Muzeu ka në përbërje të tij 5 punonjës: 1 përgjegjës me kohë të plotë, 2 ciceronë me kohë të pjeshme, 1 restaurator dhe 1 punonjës mbështetës me kohë të plotë, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkangjitet këtij vendimi.
7. Burimet e financimit të Muzeut Arkeologjik Autonom janë, si më poshtë vijon:
 - a) Buxheti i shtetit.
 - b) Të ardhurat nga shitja e biletave.
 - c) Sponsorizimet dhe donacionet dhe
 - ç) të ardhura të tjera të ligjshme.
8. Miratimin e llojit të biletave sipas lidhjes nr. 4 bashkëngjitur.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: drejtori i institutit të arkeologjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder Gjinushi

KRYETAR

